



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, të Ligjit nr. 03/ L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 04.09.2023, merr këtë

**V E N D I M**

**I.**

MIRATOHET raporti me nr. prot. 14-050/01-85384/23, i datës 28.04.2023, i Komisionit Profesional për Verifikimin e Shfrytëzimit të Pronës Komunale në Zonën Industriale.

**II.**

Duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në Raportin sipas pikës 1. të këtij vendimi, obligohet Kryetari i Kryeqytetit dhe drejtoritë tjera përkatëse të përcaktuara me këtë vendim, që t'i ndër marrin veprimet si në vijim:

1. Të gjithë personave fizikë dhe juridikë, të vendosur në pronën komunale tek Zona Industriale sipas një vendimi të mëhershëm nga Komuna e Prishtinës, të cilat janë të evidentuara në raportin e Komisionit, t'u mundësohet aplikimi për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale për periudhën njëvjeçare, në pajtim me nenin 5 dhe nenin 6, paragrafin 1.3 i Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës. Pas kalimit të këtij afati, i tërë lokacioni i Zonës Industriale të trajtohet në përputhje me kriteret e Planit zhvillimor urban të Komunës së Prishtinës.
2. Obligohet Zyra ligjore e Komunës së Prishtinës, që të analizojë aspektet ligjore dhe mundësitë që të ndërmerren procedurat e përmbarrimit ose ato gjyqësore për pagesën retroaktive të rentës për tokën e dhënë në shfrytëzim në përputhje me Rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale, 1, nr. 110-2782, neni 6, shkronja c, për të gjitha subjektet që kanë shfrytëzuar pronën komunale dhe nuk kanë paguar të hyra për Komunën.
3. Të gjitha aspektet tjera që ndërlidhen me uzurpimin e pronës komunale të përcaktuara në raportin sipas pikës 1 të këtij vendimi, duhet të ndërmerren veprime urgjente nga Drejtoria e Inspektoratit që t'i lirojë pronat komunale të evidentuara në të gjeturat dhe rekomandimet e raportit.

### III.

1. Paragrafi i parë i nenit dy të këtij vendimi, do të zbatohet brenda afatit prej 60 ditësh nga hyrja në fuqi e Rregullores për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale në periudhën deri njëvjeçare.
2. Paragrafi 2 i nenit dy të këtij vendimi, do të zbatohet brenda afatit prej 60 ditësh nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Paragrafi 3 i nenit 2 të këtij vendimi duhet të zbatohet menjëherë.

### IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Kryeqytetit, Drejtorja e Pronës, Drejtorja e Inspektoratit, Zyra ligjore dhe Drejtorja e Financave.

### V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
01-035/01-183666/23, më 05.09.2023

